



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL  
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE  
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION



---

## Intervistë e Ministrit Sadri Ferati

---

### MINISTRI FERATI: MITROVICA DO T'I KTHEHET INTEGRIMIT E JO NDARJES

PRISHTINË, 2 shkurt /Kosovanews/- Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Sadri Ferati, në një intervistë për KosovaNews ka vlerësuar se decentralizimi dhe fuqizimi i komunave është standard të cilin Kosova duhet ta implementoj më qëllim të demonstrimit se jemi shtet demokratik dhe i gatshëm për integritet evropian. Ministri Ferati thotë se implementimi i pakos së kryendërmjetësit Marti Ahtisari, në kuadër të së cilës është edhe procesi i decentralizimit, është një sfidë për Institucionet dhe shoqërinë e Kosovës. Ai thekson se integriteti i qytetit të ndarë të Mitrovicës është një problem paksa më i madh dhe më i rëndësishëm sesa meset tjera multietnike në vend. Për t'i kaluar ndasitë e mëdha në këtë qytet, ministri Ferati thotë se është shkuar në variantin një qytet me dy komuna ku të secila palë është në dilema se si do të kuptohet kjo, si disfatë, triumf apo edhe si një mundësi e mirë për qytetarët. Ai ju premton qytetarëve se do të jap kontributin maksimal që Mitrovica t'i kthehet integritetit e jo ndarjes >>>

### Kosovanews: Cilat janë prioritetet dhe sfidat kryesore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal?

Ferati: Prioritetet dhe planet tona do të jenë të fokusuar në reformën e pushtetit lokal që ka nisur nga viti 2004 dhe që tani duhet të fitoj në dinamikë. Në kuadër të kësaj reforme do të jetë edhe decentralizimi si edhe implementimi i pakos së Ahtisarit. Në këtë drejtim ne kemi filluar t'i bëjmë veprimet e para dhe tani i kemi gati tri ligje që i takojnë ministrisë së pushtetit lokal. Është gati ligji për qeverisje lokale, ligji për komuna dhe ligji për zgjedhjet lokale që do të harmonizohen më objektivat qendrore të qeverisë. Ne jemi duke biseduar edhe më partnerët mbështetës për të ngritur potencialet në kuadër të ministrisë dhe sidomos për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve nëpër qeveritë lokale që të vazhdojmë një proces të brendshëm dhe të vazhdueshëm.

### Kosovanews: Si e shihni procesin e decentralizimit?

Ferati: Procesi i decentralizimit është një rast i mirë por është edhe një sfidë. Është rast i mirë, sepse komunat mund t'i zgjerojnë kapacitetet e tyre që të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët, pastaj në zgjerimi e kompetencave në fushën e trafikut urban, në pastrimin dhe trajtimin mbeturinave të ngurta, në ujësjellës dhe kanalizim. Sfidë do të jetë edhe implementimi i komunave të reja dhe në ngritjen e kapaciteteve të atyre komunave që të jenë të dobishme për qytetarët dhe për të krijuar relacione edhe me nivelin qendror. Ne dëshirojmë dhe besojmë se të gjitha këto kompetenca, e sidomos për komunat e reja, do të shfrytëzohen nga udhëheqësit komunal në dobi të qytetarëve dhe jo për të demonstruar ndonjë relacion në raport më të tjerët.

### **Kosovanews: A mendoni se decentralizimi është sfida kryesore pas pavarësisë?**

Ferati: Implementimi i pakos së Ahtisarit, e në kuadër të saj edhe vet decentralizimit, është një sfidë, sepse ende është diçka që është më një të panjohur që të funksionalizohen këto njësi në dobi të gjithë qytetarëve.

### **Kosovanews: Shumë nga vendbanimet shqiptare që më decentralizim kanë ndërruar komunën janë të pakënaqur më këtë proces. Si do të arrini t'i bindni ata?**

Ferati: Bindja e tyre duhet të konsistojë më dobinë që do të kenë si qytetar dhe se dobia e tyre do të jetë në funksionalizim të një pushteti. Nëse në një Kosovë e cila respekton standardet më të larta të ushtrimit të pushtetit është shumë lehtë që secili të ndihet i barabartë.

### **Kosovanews: Decentralizimi ka krijuar edhe një serë komunash të banuara me pakicën serbe, mirëpo ende ka hezitim që ato të bashkëpunojnë me Prishtinën. Çfarë do të ndërmerrni që një gjë e tillë të funksionalizohet?**

Ferati: Obligimet dhe përgjegjësitë e ministrisë shkojnë në drejtimin të monitorimit të komunave, por prioriteti dhe roli më i madhe i kësaj ministrie është ndihmesa për këto komuna. Ne presim fuqizimin e tyre duke filluar nga ngritja e kapaciteteve deri tek sqarimi i plotë i kompetencave që do t'i kenë. Unë besoj se kjo do të jetë në interes të gjithë qytetarëve dhe komunave pa përjashtim, sepse nuk dëshirojmë që një pjesë e qytetarëve të Kosovës të ketë interes fuqizimin e pushtetit lokal dhe një pjesë tjetër jo. Pas pavarësimit të Kosovës do të kemi një opsion real, sepse Kosova është shtet dhe në tërësinë e saj territoriale.

### **Kosovanews: Ju thoni se do të ketë bashkëpunim më komunat më shumicë serbe. Kur pritet të filloj ky bashkëpunim?**

Ferati: Në aspektin e ditës 'D+ 1' nuk janë shumë i sigurt, por mendimi im është se përveç fazës së tranzicionit që do të jetë për ndihmësen e komunave që ata të mësohen për ngritjen e kapaciteteve të tyre, duhet që të definohet edhe interesin i tyre që ato të funksionojnë fuqishëm. Pse mos të shpresojmë se ushtrimi i pushtetit do të definohet ashtu sikur që e ka biznesi. Ashtu siç bëhet biznesi mes shqiptarëve dhe serbëve shumë lehtë, prandaj edhe ushtrimi i pushtetit do të konsiderohet si interes për të gjithë qytetarët, dhe ajo do të ndodhë.

### **Kosovanews: Çështja e decentralizimit ka zgjuar reagime të shumta si një mundësi e ndarjes së këtyre pjesëve. Si e komentoni këtë?**

Ferati: Mendoj se në gjithë Evropën trend do të jetë fuqizimi i qeverisjes lokale që pushteti të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jetë më aktiv në vendimmarrje. Unë personalisht mendoj se rreziku i sjelljes se kësaj forme nuk është centralizimi, mund të marrim një shembull ku Serbia centralizoj çështjen e Kosovës duke ia marrë autonomin, por nuk ka arritur që t'i merr aspiratat e shqiptarëve, prandaj edhe më decentralizim nuk arrihet ajo. Qëllimi është ky, Kosova të shpallet shtet i pavarur dhe i pacenueshëm territorialisht, sepse do të kemi interes që të bashkëpunojmë më të gjithë të tjerët që të ndërtojmë një jetë më të mirë, ndërsa vet decentralizimi do të jetë standard nëse ne pretendojmë që ti ngrisim kapacitetet tona. Decentralizimi dhe fuqizimi i komunave është standard që ne duhet ta plotësojmë përveç që të ofrojmë një jetë më të mirë për qytetarët, ne duhet që edhe të demonstrojmë se jemi një shtet demokratik dhe jemi një shoqëri serioze dhe e pjekur drejt integriteteve evropiane.

**Kosovanews: Sfidë të madhe do të paraqes edhe integrimi i qytetit të ndarë të Mitrovicës i cili më decentralizim është ndarë në dy njësi komunale që do të udhëhiqen nga një administratë qendrore. Për sa kohë mendoni që Mitrovica do të jetë NJË?**

Ferati: Çështja e Mitrovicës është një problem paksa më i madh dhe më i rënd sesa meset tjera multietnike. Të dy komunitetet janë të fuqishme prandaj kemi formimin e dy komunave në kuadër të qytetit të Mitrovicës. Te secili është dilema se si do të kuptohet kjo, si disfatë, si triumf apo do të kuptohet si një mundësi më e mirë për qytetarët. Unë dua që të kuptoj se formimi i dy komunave është një rast më i mirë që të tejkalohet gjendja momentale. Më këtë do të përfitonin shumica shqiptare dhe është një shancë për vetë administrim që të hiqen dilemat se pushtetit qendror do të censuroj ndonjë të drejt.

**Kosovanews: Personalisht ju kur pritni krijimin e mirëbesimit mes pjesës veriore dhe jugore të Mitrovicës?**

Ferati: Duhet të ketë këmbim të vlerave dhe dalëngadalë qyteti do të ketë interes që të shkrij shumë funksione nga një pjesë në pjesën tjetër të qytetit. Unë nuk mund të di se si do të jenë reagimet në momentin e parë, mirëpo kjo do të ndodhë shumë shpejt dhe bordi i cili është i paraparë dhe përfaqësuesi civil ndërkombëtar që do të jetë më kompetenca të fuqishme në këtë drejtim, do të kishin pasur shumë pak punë. Më këtë do të ishin identifikuar qysh në fillim fushat e interesit, nga shërbimet publike, fabrikat e ujit, spitali, ngrohja qendrore, stadiumi, qendra e kulturës, etj.

**Kosovanews: Në Kosovë tani kemi edhe tri pilot njësi që funksionojnë sipas një udhëzimi administrativ nga UNMIK-u. Kur pritët që këto njësi të shndërrohen në Komuna të vërteta?**

Ferati: Pas shpalljes se pavarësisë, Kosova merr obligim që të implementoj pakon e Ahtisarit dhe kjo është çështje decidive në këtë pako. Kjo do të ndodhë gjatë fazës së tranzicionit, gjatë periudhës më të shkurtër të mundshme pas shpalljes se pavarësisë.

**Kosovanews: Sa do të jetë e vështirë mbijetesa e këtyre pilot njësive?**

Ferati: Pilot njësive u është vazhduar mandati dhe ato duhet të vazhdojnë që të ngrisin kapacitete e tyre për të dëshmuar se ai lokalitet dhe ajo administratë është në dobi të qytetarëve. Këto pilot njësi janë pjekur për t'u shndërruar në komuna, mirëpo paraprakisht duhet të jepet një vlerësim i performancës.

**Kosovanews: A do të mund të ketë komplikime buxhetore me shtimin e numrit të komunave që dalin nga procesi i decentralizimit?**

Ferati: Gjithësi se kjo do t'i bëhet ngarkesë buxhetit të Kosovës, mirëpo kjo duhet të planifikohet nga ne në kohën e ndarjes së buxheti. Motivi mbi të cilin janë formuar këto komuna e arsyeton ndarjen e buxhetit, prandaj ministria e financave duhet të planifikoj buxhetin për formimin dhe funksionimin e komunave të reja.

**Kosovanews: Kur do ta ketë Prishtina statutin e kryeqytetit në formë ligjore?**

Ferati: Shumë shpejt ne do të fillojmë procedimin e kësaj çështje që do të shndërrohet në ligj i cili më pastaj do duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.

**Kosovanews: Çfarë përfton kryeqyteti më këtë statut?**

Ferati: Kryeqyteti mund të përfitoj shumë. Kryeqyteti do të ketë të drejtën e riorganizimit në më shumë se një njësi administrative, do të ketë mundësi që të decentralizoj shumë shërbime dhe favore tjera.